

ELINDË DIBRA & RREZARTA DRAÇINI

KRIJIMTARIA LETRARE DHE GJUHËSORE E MARTIN CAMAJ-T, BOTUAR NË REVISTËN “SHEJZAT” (LE PLEIADI)



Në gushtin e vitit 1957, në Romë, doli numri i parë revistës periodike “Shejzat”¹, me një emër kuptimlotë, siç vihet në dukje nga hartuesit: “Hyllësi vërtetesh arbnore”². U botua për plot 18 vjet (57-75). Në vitin 1978, nën kujdesin e drejtpërdrejtë të krahut të djathtë të Koliqit, Martin Camaj, u botua një numër përkujtimor në nderim të botuesit të saj, prof. Ernest Koliqit. Kjo revistë u botua si

pasardhëse e denjë e revistave të përkohshme, që u botuan në Shkodër si “Hylli i Dritës”, “Illyria”, “Shkëndija”. Ndonëse nuk u botua në Shqipëri, ajo mund të konsiderohet si revista më e denjë që i shërbeu çështjes, kulturës, historisë dhe traditave shqiptare në një kohë kur “ligjet” e truallit-mëmë shpallnin të padëshiruar zërat dhe mendjet më të shquara të kombit. Përgjatë gjithë periudhës së botimit, Martin Camaj, kryeredaktor i kësaj reviste prestigjioze që një nga zërat më të spikatur të letërsisë dhe gjuhësisë shqiptare.

¹ Shejzat (le Pleidi), revistë e përkohshme kulturore, shoqërore dhe artistike. Drejtues i përgjithshëm: Matilda Mancinelli, kryeredaktor Martin Camaj, pronar Ernest Koliq. Në vitin e XII të botimit redaktor për pjesën Gjermani u emërua Peter Bartl ndërkohë që filloi funksionimi i Këshillit të Kryesisë: Martin Camaj, Giuseppe Gradilione, Gerhard Grim, Karl Gurakuqi, Claus Haebler, Ernest Koliqi, Giacomo Marlekaj, Rosolino Petrota, Giuseppe Schiro, Alois Schmaus, Georg Stadtmüller, Giuseppe Valentini.

² Koliqi, Ernest, “Mbas udhëheqjes së Shejzavet, në “Shejzat”, 1957, nr 1, f.2.

Fushat kryesore që trajtuan studimet dhe artikujt në revistën “Shejzat” gjatë viteve të botimit të saj përfshijnë aspektet e letërsisë, gjuhësisë, kritikës, historisë, kulturës dhe politikës shqiptare. U botuan 1633 artikuj, studime, recensione, bibliografi, kronika, kritikë, krijimtari letrare etj.

Revista nën drejtimin e prof. Ernest Koliqit dhe nën kujdesin e veçantë të shkrimtarit dhe të albanologut të shquar Martin Camaj, u paraqit si një enciklopedi e vërtetë e botës së lashtë dhe asaj bashkëkohore shqiptare. Niveli intelektual dhe kulturor i bashkëpunëtorëve më të afërt të “Shejzave” ishte evropian dhe veprimtarinë e tyre e përshkon një ndjenjë e fuqishme shqiptarizmi. Revista botoi krijimtari letrare, folklore, studime dhe artikuj, rubrika dhe kronika kulturore në gjuhën shqipe, italiane, gjermane, angleze dhe franceze. Kjo revistë u themelua në kohën e izolimit të thellë të Shqipërisë e për rrjedhojë, arsyeja kryesore e krijimit të saj sipas themeluesve kishte për qëllim “... të kryemit e një detyre intelektuale kundrejt atdheut, shi në kohë kur në kuadratin e historisë grepat po shënojnë një çast rreziku jetëshues”.³ Për arritjen e këtij qëllimi shumë fisnik dhe fort të dëshiruar, mjeti i vetëm që do të përdorej duhej të ishte kultura: “...me armën e kulturës, nëpër rreze të së cilës, çështja e shqiptare mund të zgjidhet lumnisht”.⁴

Karl Gurakuqi, një ndër emrat e spikatur të “Shejzave” në shkrimet e tij bibliografike, “Nëpër vullajt e Shejzavet”, thekson: “Martin Camaj asht kryeredaktori i Revistës, krahu i djathtë i prof. Koliqit, qysh prej numrit të parë të botimit, në gushtin e vjetit 1957 dhe sot e kësaj dite. Asht kot të tjerim lëvdata për Martin Camajn pse bota intelektuale shqiptare e njëj mirfilli nga botimet që na ka dhanë dhe nga artikujt-studime që ka shkruar për revistën e mikut të vet “Shejzat”. Ka shkruar gati në çdo numër të *Saj pa përtesë*, vetëm për t’i shërbye gjuhësisë dhe letërsisë shqipe, e për të krye një barrë që tash ma shumë se dhjetë vjet ka marrë përsipër për t’i shërbye shtypit shqiptar në mërgim.”⁵

Kjo revistë është mirëpritur jo vetëm nga një numër i madh të interesuarish shqiptarë dhe të huaj, por edhe nga mjaft institucione dhe biblioteka. Ajo i është dërguar falas 100 bibliotekave dhe institucioneve kulturore të botës mbarë, një tube të madhe studieshish albanologjie dhe qindrave e qindrave shqiptarëve në mbarë botën.

Thuajse në çdo numër ndeshemi me Camajn poet, prozator, studiues i letërsisë dhe gjuhësisë, kritik, gramatikan, përkthyes, i cili sjell realizime,

³ Koliqi, Ernest, “Mbas udhëheqjes së Shejzavet, në “Shejzat”, 1957, nr. 1, f. 2.

⁴ Ibidem, 1957, nr. 1, f. 2.

⁵ Gurakuqi, Karl, *Nëpër vullajt e Shejzave*, Shejzat (Plejadi), nr. 10, Romë 1967.

risi dhe befasi. Është rreth 100 numri i artikujve të botuar në revistë me firmën e Camajt në këto faqe. Një kontribut shumë të vyer ky personalitet realizoi edhe nepërmjet korespondencave me emra të njohur të gjuhësisë dhe letërsisë perëndimore, të cilët u bënë jo vetëm miqtë e tij, por edhe bashkëpunëtorët e kësaj reviste.

Vetë themeluesi i “Shejzave” prof. Koliqi në dhjetëvjetorin e kësaj reviste në faqet e saj pohon që forcën dhe frymëzimin për “Shejzat” e gjeti tek Camaj. *“Ardhja e Martin Camajt në Romë me trimnoi me hy edhe një herë në valle të botimeve. Me bashkëpunimin e tij vëllaznuer dolën në dritë ‘Shejzat’. Martini vinte në Romë i përgatitun shkencërisht në gjuhësi si nxanës i prof. Bariçit dhe i paisun me vetina të rralla letrare. Por sjellte me vete edhe dishka ma tepër: njomsin agimore të letërsisë së Kosmetit. Ai dishmit e para të frymzimit të lum poetik i kishte dhanë në Kosovë. E ndiente veten si pjesmarrës i ngushtë në lëvizjen kulturore t’asak krahine. Edhe sot orthografia e tij ndjek normat e vendosuna ndër mbledhje kulturore kosovare. Ajo frymë më rinoi e më shkakttoi në mue një ringjallje fuqish. Pinjuell i një breznie tjetër, ndjekës i asaj rrymbe qi pat Fishtën e Mjedën për mjeshtira, un ndjeshëm nevopjën për m’u përtri letrarisht, m’u vu me hap t’em n’rhythem të kohës së re , natyrisht pa u zhgulë nga rrajët e vjetra, m’u zhyt në lulzim prendveruer qi cilëson letërsinë e Kosmetit, si n’ujna mrekullbasë qi këthejnë shpirtin në stinën e prillit të jetës..”⁶*

Në numrin e parë të revistës e shohim tek prezantohet në cilësinë e poetit me krijimet “Vendit tem”, “Shiu mbi lum”, “Poezija e rilindjes” dhe “Brezi i Vektare”. E fillon me një hymnin lirik Vendlindjes, për të cilën mendja dhe shpirti i janë bërë një deri në ditën e fundit ku mbi varr do t’i vendosej një copë shkamb nga viset e tij duke realizuar një dëshirë: atë të lidhjes mitike me tokën mëmë nepërmjet një force simbol shkëmbore. Në radhët e Shëjzavet gjejmë edhe poezitë “Mimozat”, “Poetit të dekun”, “Shiu mbi lum”, “Brezi i vektare” vëllimin “Legjenda” etj. të këtij autori. Ndërsa në prozë botoi tregimet: “Dy pushkë që ranë te arka e Gegës”, “Vendi që përngjante një zgjoni bletësh”, “Udhëtari majë mushkut”, “Arka e Noelit dhe Bestytni”. Një vend të gjerë në faqet e Shejzave vëmë re se zënë një numër i konsiderueshëm i artikujve, studimeve, recensioneve mbi probleme të ndryshme letrare: “Nepër fletët e nëntorit”, Me mjaft interes parqiten dy studime mbi veprën e At Gjergj Fishtës: “Shndërrimi dhe përpunimi i thanjeve popullore në Lahutën e Malcisë” si dhe “Kumtime të reja mbi Fishtën”. Në përvjetorët e

⁶ Hilushi (Koliqi, Ernest), Malli i Shtampës- “Shejzat”, Vjeti X, shtatuer – dhetuer, 1966, f. 307-308.

ditëlindjeve të Budit dhe Mjedës boton dy studime të veçanta. Mjaft interes paraqesin edhe pikëpamjet e Camajt në lidhje me periodizimin e letërsisë shqiptare si dhe mbi zhvillimin e letërsisë së mbas luftës në Shqipëri. Në një këndvështrim interesant paraqiten edhe studimet “*Rreth prozës së sotme në Shqypni*”, “*Një shikim poezisë së vjetit 1957 në Shqypni*” ndërsa interesohet dhe vlerëson kulturën arbëreshe veçojmë studimin “*Nji paraqitje e tanishme e poetit arbresh Francesco Crispi Glaviano*”, sull elementi dei canti popolari nelle rapsodie dello Schirò, 100 vjetori i lindjes së Ndre Mjedës.



Studimet dhe krijimtaria letrare e gjuhësore e botuar në revistën “Shejzat” ngjajnë të jenë për Camajn dy bija fort të dashura. Herë në letërsi e herë në gjuhësi, aftësitë e tija, përkufizohen me ato të një krijuesi dhe studiuesi me zë të shqipes. Ndër artikujt që Camaj ia dedikon studimeve gjuhësore veçojmë “*Për vokalin nazal ke Buzuku*”, “*Jeronim de Rada për gjuhësinë shqipe*”. “*Me mjaft interes janë edhe studimet gjuhësore mbi të folmen dhe traditën e arbëreshve, ndër të cilat përmendim: “Ndër katundet arbreshë në Kalabri”, “Udhëtim veruer nëpër Arbreshë të Kalabrisë”, “Sull’elemento dei Canti popolari nelle rapsodie dello Schirò”, “Gjurmë të popullsisë shqiptare në provincën e Piacenzës”.*

Camaj në cilësinë jo thjesht të një kryeredaktori, por më së shumti të një kuratori të vëmendshëm e shumë të kujdesshëm, u përpoq që në këtë plejadë të pasqyronte botën shqiptare së bashku me rrethin e

bashkëpunëtorëve, studiuesve shqiptarë si dhe emra të njohur të botës albanologjike perëndimore. U përpoq së bashku me mikun e tij Ernest Koliqi që thujse në çdo numër të paraqiste rubrika të tilla si kronika kulturore, recensa të ndryshme në lidhje me aktivitetet dhe konferencat ndërkombëtare.

Bibliografi e krijimtarisë, studimeve, analizave, recensave të Martin Camaj-t, botuar në revistën “Shejzat”

1. **CAMAJ, Martin:** “Vendit tem”, “Shiu mbi lum”, “Poezija e Rilindjes”, “Brezi i vektarës”, -Vjeti I, Gusht 1957, nr.1, f.10-11.
2. **CAMAJ, Martin** *Nji prrallë arbreshe: Ai q’i bij karamunzes(Lauretta ka Shen Sofia), Ai që I binte zanamares (shqipërim)*, Vjeti I, Gusht 1957, nr.1, f.22-26.
3. **CAMAJ, Martin:** Kronikë kulturore “Sagra degli Albanesi- Kuvend poezije shqiptare. - Vjeti I, Gusht 1957, nr 1, f. 30-31.
4. **CAMAJ, Martin:** Libra të lexuem- Vasil D. Alarupi, *Dasmë në shtëpi të Vançit*. Vjeti I, shtatuer- tetuer, nr.1-2, f. 95.
5. **CAMAJ, Martin:** *Dy pushkë që ranë te “Ara e Gegës”*.- Vjeti I, nanduer-dhetuer, nr 4-5, 1957, f. 123-135.
6. **CAMAJ, Martin:** “Mimozat”, “Poetit të vdekun”, Vjeti II, kallënduer-fruer, nr.1-2, f.14-15.
7. **CAMAJ, Martin:** “Nepër fletët e “Nëndorit”, revistë letrare-artistike, shoqërore-politike, nr. 8, Tiranë, 1957. - Vjeti II, Mars-Prill 1958, nr.3-4, f.102-105.
8. **CAMAJ, Martin:** Libra të lexuem- Stavro Skendi. “Mendimi politik dhe veprimtaria kryengritëse shqiptare(1881-1912) -Vjeti II, Maj- Qershtuer, nr 5-6, f. 199-200.
9. **CAMAJ, Martin:** Nji shkim poezis të vjetit 1957 në Shqipni. – Vjeti II, Korrik-Gusht 1958, nr. 7-8, f. 227-235.
10. **CAMAJ, Martin:** Zoshçenko Mihail “Nji lojë e pahijshme”, (përkth.)- Vjeti II, shtatuer-tetuer, 1958, nr 9-10, f. 311-313.
11. **CAMAJ, Martin :** Libra të lexuem (Tonin Miloti, “Zanusha”, poemë - Vjeti II, shtatuer- tetuer, nr.9-10, f.342.
12. **CAMAJ, Martin:** Kronikë kulturore (Kremtimi i 28 Nantorit në Romë – Vjeti II, nanduer- dhetuer, 1958, nr. 11-12, f. 409.
13. **CAMAJ, Martin:** Valentini Giuseppe “Per una storia dell Albania”(përkthim)/ Për një histori të Shqipnis- Vjeti III, kallnduer – fruer, nr 1-2, f.56-60.
14. **CAMAJ, Martin:** P. Gj. Skiroi, Kryepift në Piana, Vjeti III, kallnduer-fruer, 1959, nr 1-2, f. 64.
15. **CAMAJ, Martin:** Pasternak, Boris,”Udhëtimi i fundit”, Vjeti III, mars- prill, 1959, nr 3-4, 119-121.

16. **CAMAJ, Martin:** *Për vokalin nazal ke Buzuku*. – Vjeti III, Maj-Qershuer 1959, nr. 5-6, f. 163-174.
17. **CAMAJ, Martin:** *Ndër katundet arbreshe në Kalabri*, Vjeti III, 1959, korrik-gusht, nr 7-8, f. 281-283.
18. **CAMAJ, Martin:** Festimet e Ungrës- Vjeti III, shtatuer- tetuer, 1959, nr 9-10, f. 332-334.
19. **CAMAJ, Martin:** *“Petrarka”, “Fryma e bletës” “Valle Rugove”, “Verë e lumtun”*- Vjeti III, nanduer- dhetuer, 1959, nr 11-12, f. 385-386.
20. **CAMAJ, Martin:** *Libra të lexuem (Giacomo Marlekaj. La più antica pubblicazione in lingua Albanese. “Quaderni di Glottologia”*– Vjeti III, 1959, nanduer- dhetuer, nr 11-12, f.428.
21. **CAMAJ, Martin:** *Libra të lexuem (Arshi Pipa, Libri i burgut, Romë 1959)*, Vjeti IV, 1960, kallnduer- fruier, nr 1-2, f. 52.
22. **CAMAJ, Martin:** *Ligrata e prof. Franz Babinger mbi Konstantin Arianit Komnenin*- Vjeti IV, 1960, mars- prill, nr 3-4, f. 80-81.
23. **CAMAJ, Martin:** *Rreth prozës së sotme në Shqipni*. - Vjeti IV, Shtatuer-Tetuer 1960, nr. 9-10, f. 291-299.
24. **CAMAJ, Martin:** *Udhëtim veruer nëpër Arbreshë të Kalabrisë*. – Vjeti V, Korrik-Gusht 1961, nr. 7-8, f. 254-256.
25. **CAMAJ, Martin:** *Idriz Ajeti, “Pamje historike e ligjërimin shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX”*. - Rilindja, Prishtinë 1960. – Vjeti V, Korrik-Gusht 1961, nr. 7-8, f. 270-272.
26. **CAMAJ, Martin:** *Shëndrrimi e përpunimi i thanjeve popullore në “Lahutën e Malcis”(Trasformazione ed elaborazione delle frasi idiomatiche nel “Liuto delle Montagne”)*. – Vjeti V, Nanduer-Dhetuer 1961, nr. 11-12, (Numër përkujtimuer për 90 vjetorin e lindjes së Gjergj Fishtës), f. 477- 485.
27. **CAMAJ, Martin:** *Kremtimi i Flamurit në Romë – 60 Vjetori i prof. Schmaus (kronikë kulturore)*- Vjeti IV
28. **CAMAJ, Martin:** *“Ferri”, e para kantikë e “Komedis Hyjnore” në gjuhën shqipe*. (Dante Alighieri: Komedia Hyjnore [I], përkthye prej origjinalit nga Pashko Gjeçi, redaktue nga Lllazar Siliqi. N.SH. e Botimeve “Naim Frashëri”, Tiranë 1960). – Vjeti VI, Maj-Qershuer 1962, nr. 5-6, f. 149-157. (Filologji, teori e përkthimit, leksikologji)
29. **CAMAJ, Martin:** *Konferencë e Koliqit në München; ndikimet lindore e perëndimore në letërsinë shqipe*, - Vjeti VI, maj- qershor, nr 5-6, f. 202-203.
30. **CAMAJ, Martin:** *Vepra e fundit e Ivan Popović dhe çashtja e prejardhjes së shqiptarëve /Ivan Popović, “Geschichte der Serbokroatischen Sprache”, Otto Harrassoëitz – Wiesbaden 1960 – F. XVIII + 687 /.* – Vjeti VI, Korrik-Gusht 1962, nr.7-8, f. 236-239.
31. **CAMAJ, Martin:** *Kumtime të reja mbi Fishtën*. – Vjeti VI, Shtatuer-Tetuer 1962, nr. 9-10, f. 304-306.
32. **CAMAJ, Martin:** *Mbledhja e balkanologëve në München (7--10 nanduer 1962)*. – Vjeti VI, Nanduer-Dhetuer 1962, nr. 11--12, f.365-368.

32. **CAMAJ, Martin:** Nji konferencë e profesor Schmaus mbi epikën popullore shqiptare në Universitetin e Romës. - Vjeti VII, Mars-Prill 1963, nr. 3-4, f. 77-79.
33. **CAMAJ, Martin:** Fjala qet fjalën: Në rasën e gjashtëdhjetëvjetorit të lindjes së Ernest Koliqit. - Vjeti VII, Maj-Gusht 1963, nr. 5-6-7-8, f. 149-150.
34. **CAMAJ, Martin:** *Legjenda*(Drin: “Mjellma dhe nusja”, “Burri dhe ura e votrës”, “Burri I pabesë”, “Gruaja që dinte shumë”, “Breznia e re apo bija e grues”, “Ai që i bien fyellit në hanë”, “Për kaun e mbytyn në kohë të ujës”, “Dy korba”, “Bletët”, “Korbi”, “Hija e Gjergj Kastriotit”, “Vada”, “Kalorsi”, “Dita e pranveravet”, “Lugu i gjarpnit”, “Ledja”, Vjeti VII, maj- gusht, 1963, nr 5-8, f.288-305.
35. **CAMAJ, Martin:** *Legjenda* (“Liçeni i Prevezës, Beka I verbët”, “Zoti I lumit sqapi”, “Qokthi”, “Nusja e bjeshkës”, “Vajtorja”“Guri i shpirtit”, Vjeti VII, shtatuer- tetuer, 1963, nr 9-10, f.347-359.
36. **CAMAJ, Martin:** *Maximillian Lambertz(1882-1963)-* Haebler, Claus (përkthim)
37. **CAMAJ, Martin:** Nji vepër me randësi e djalektologjisë shqipe / Idriz Ajeti, “Istoriski razvitak govora Arbanasa kod Zara”, botim i NDNRBIIH, Djela, XVI, Instituti Balkanologjik, 3. Sarajevë, 1961 /. – Vjeti VIII, Kallënduer-Fruer 1964, nr.1-2, f.69-70.
38. **CAMAJ, Martin:** Nji paraqitje e tansishme e poetit arbresh Francesco Crispi Glaviano (Presentazione del poeta italo-albanese Francesco Crispi Glaviano). - Vjeti VIII Mars-Prill 1964, nr.3-4, f.116-118.
39. **CAMAJ, Martin:** *Libra të lexuem*, -Vaclav Polak, les origins de la différenciation dialectale en albanie në Orbis(Bulletin international de documentation linguistique) Tome XII, N.2,f. 381-392, Louvain), Vjeti VIII, mars- prill, 1964, nr 3-4, f. 137-139.
40. **CAMAJ, Martin:** Jeronim De Rada për gjuhësinë shqipe. - Vjeti VIII, Korrik-Tetuer 1964, nr.7-8-9-10, f.332-336.
41. **CAMAJ, Martin:** *Kronikë kulturore,Konferenca e professor Zef Schiroit në Universitetin e München-it*, - Vjeti VIII, korrik- tetuer, 1964, nr.7-10, f.447.
42. **CAMAJ, Martin:** *Libra të lexuem*,(Tajar Zavalani, The P.E.N, in Exile; Albanians. “Arena”, 3/6(1964), 9-85, Londo, Vjeti VIII, korrik- tetuer, 1964, nr 7-10, 446.
43. **CAMAJ, Martin:** *Vendi që i përngjante nji zgjoni bletësh-* Vjeti IX,kallënduer- fruer, 1965, nr 1-2, f. 14-20.
44. **CAMAJ, Martin:** Jeta dhe vepra e Johann Georg von Hahn. - Vjeti IX, Kallënduer-Fruer 1965, nr.1-2, f.48-52.
- 45.**CAMAJ, Martin:** *Libra të lexuem: Ndre Mjeda”Juvenilja”e vepra të tjera.* Tiranë, 1964, Vjeti IX, Kallënduer-Fruer 1965, nr.1-2,f. 68-70.
- 46.**CAMAJ, Martin:** *Nji trim që këndohej ndër kangë popullore-* Vjeti IX, mars-prill, 1965, nr 3-4, f. 97-104.
47. **CAMAJ, Martin:** *Udhëtari maje mushkut* - Vjeti IX, mars- prill, 1965, nr 3-4, f. 156-160.

48. **CAMAJ, Martin:** Romani i “Eshtnave”/Ismail Kadare, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”/ - Vjeti IX, Korrik-Gusht 1965, nr.7-8, f.257-260.
49. **CAMAJ, Martin:** Libra të lexuem “Zeitschrift für Balkanologie 1 (1963), 1/2- Vjeti IX, Korrik-Gusht 1965, nr.7-8, f.286-287.
50. **CAMAJ, Martin:** “Purgatori” e dyta kantine e Komedisë Hyjnore në gjuhën shqipe - Vjeti IX, shtatuer- tetuer, 1965, nr 9-10, f. 315-320.
51. **CAMAJ, Martin:** Ribotim kritik i veprës së Matrangës. - Vjeti IX, Shtatuer-Tetuer 1965, nr.9-10, f.351-352.
52. **CAMAJ, Martin:** Sull’elemento dei Canti popolari nelle rapsodie dello Schirò (Mbi elementin e këngëve popullore në rapsoditë e Zef Skiroit). – Vjeti IX, Nanduer-Dhetuer 1965, nr.11-12, f.396-398.
53. **CAMAJ, Martin:** Libra të lexuem – Carlo Tagliavini, Gli etnici dei paesi albanesi d’Italia(Estratto dagli “Atti di Istituto Veneto di scienze, lettere ed arti”Anno Accademico 1963-1964, pagg. 551-568)- Vjeti IX, nandue –dhetuer, 1965, nr 11-12, f. 429-432.
53. **CAMAJ, Martin:** Arka e Noehit apo friga – Vjeti X, mars- prill, 1966, nr 3-4, f. 93-97.
54. **CAMAJ, Martin:** Kronikë kulturore [L’insegnamento della lingua Albanese – Mbyllja e kremtimeve të Njiqindvjetorit të datlindjes së Poetit Zef Schiroi në Napull- Vjeti X, mars- prill, 1966, nr 3-4, f. 133-140.
55. **CAMAJ, Martin:** *Njiqind vjetori i lindjes së Ndrë Mjedes(1866-1966)*. Letrat e Ndrë Mjedes dërgue Gustav Majerit – Vjeti X, maj- qershtuer, 1966, nr 5-6, f. 184-185.
56. **CAMAJ, Martin:** *Professor Mhill Marku u nda nesh-* Vjeti X, korrik- gusht, 1966, nr 7-8, f. 225-226.
57. **CAMAJ, Martin :** Kronikë kulturore- *Kongresi i balkanologëve në Sofje-* Vjeti X, korrik- gusht, 1966, nr 7-8, 258.
57. **CAMAJ, Martin:** Pjetër Budi – me rastin e katërqindvjetorit të lindjes-Vjeti X, shtatuer-dhetuer 1966, nr.9-12, f.494-496.
58. **CAMAJ, Martin:** Mendime rreth zhvillimit të letërsisë së Mbasluftës në Shqipëri. (Considerazioni sullo sviluppo della letteratura nel dopoguerra in Albania). – Vjeti X, Shtatuer-Dhetuer 1966, nr.9-12, f.511-514.
59. **CAMAJ, Martin:** Nji ligjratë e e prof. Dr. Georg Stadtmüller në Universitetin e Romës. – Vjeti XI, kallduer- prill 1967, nr.1-4, f.117-122.
60. **CAMAJ, Martin:** Zhdukja e një dashamiri të shqipes (Prof. dr. Wilhelm Wissmann- Vjeti XI, kallduer- prill 1967, nr.1-4, f.156-163.
61. **CAMAJ, Martin:** Beiträge zur SÜDOSTEUROPA-FORSCHUNG. Anlässlich des Internationalen Balkanologenkongresses in Sofia 26.VIII-1.IX.1966. Herausgegeben von Arbeitskreis Südosteuropa-Forschung bei der Deutschen Forschung Gemeinschaft. Redaktion: Alois Schmaus. [Verlag] Dr. Rudolf Trofenik. München 1966. S.I-V, 1-469. (Artikuj në revistën “Südosteuropa Forschung”. Me rastin e Kongresit të Parë Ndërkombëtar të Balkanologëve në Sofje, 26.VIII-1.VIX.1966. Botuar nga Shoqata e Studimeve të Europës

- Juglindore pranë Bashkësisë së Studimeve Gjermane). -Vjeti XI, Kallënduer-Prill 1967, nr. 1-2-3-4, f. 163-164.
62. **CAMAJ, Martin:** Vdiq profesor Dr. Franz Babinger. (Decesso del Prof. Babinger). – Vjeti XI, Maj-Gusht 1967, nr.5-6-7-8, f.192-194.
63. **CAMAJ, Martin:** Pikpamje rreth periodizimit të letërsisë shqipe (Punti di vista intorno alla periodizzazione della letteratura albanese). – Vjeti XI, Maj-Gusht 1967, nr.5-6-7-8, f.265-272.
- 64.**CAMAJ,Martin:**Dhimitër Xhuvani, “*Midis dy netëve*”, Shtëpia Botonjëse “Naim Frashëri”, Tiranë 1965. Fq. 124. - Vjeti XI, Maj-Gusht 1967, nr.5-6-7-8, f. 315.
65. **CAMAJ, Martin:** Disa letra tjera të Poetit Ndre Mjedja (Altre lettere del Poeta Mjedja). – Vjeti XI, Shtatuer--Dhetuer 1967, nr.9-10-11-12, f.326-331.
66. **CAMAJ, Martin:** *Dasma*. (Roman i ri i Ismail Kadaresë). - Vjeti XI, Shtatuer-Dhetuer 1967, nr.9-10-11-12, f.469--472.
67. **CAMAJ, Martin :** Konferenca e professor Zef Valentinit në Universitetin e München-it [me temë ; Mundësitë praktike të një fushate lufte së përgjakshme evropiane kundra turqve në kohën e Skënderbeut] Vjeti XII, kallnduer- mars, 1968, nr.1-3, f.83-86.
68. **CAMAJ, Martin:** Karl Gurakuqi, “*Grammatica albanese dell’uso moderno*”. II edizione riveduta e ampliata con prefazione di Giuseppe Valentini (Ad uso degli studenti universitari di Lingua e Letteratura Albanese). Centro Internazionale di Studi Albanesi, n.10 – Palermo 1967. - Vjeti XII, Kallënduer-Mars 1968, nr.1-2-3, f.124-125.
69. **CAMAJ, Martin:** Drama e fabrikës /Fadil Paçrami, “*Ngjarje në fabrikë*”(Dramë në dy pjesë). Nëndori, 4(1968)/. – Vjeti XII, Prill-Qershtuer 1968, nr.4-5-6, f.256-257.
70. **CAMAJ, Martin:** *Bestytia*- Vjeti XII, korrik- dhetuer, 1968, nr 7-12, f. 331-339.
71. **CAMAJ, Martin:** Georg Stadtmüller për historinë shqiptare (Stadtmüller per la storia albanese) / G. Stadtmüller, “Forschungen zur albanischen Frühgeschichte”(Gjurmime rreth historisë së lashtë shqiptare) – zweite erweiterte Auflage. 1966. Otto Harrassowitz. Wiesbaden. Albanische Forschungen Band 2./ - Vjeti XIII, Kallënduer--Mars 1969, nr.1-3, f.28-30.
72. **CAMAJ, Martin:** *Libra të lexuem* “Gjurmime albanologjike”1(1968)- Botim i Institutit Albanologjik të Prishtinës. – Vjeti XIII, Kallënduer-Mars 1969, nr.1-2-3, f.124-125.
73. **CAMAJ, Martin:** *Libra të lexuem* – Arshi Pipa “Rusha”, München, 1968, Vjeti XIII, Kallënduer--Mars 1969, nr.1-3, f.121-127.
74. **CAMAJ, Martin:** *Zonja Vangjeli u nda nesh* -Vjeti XIII, prill – qershtuer 1969, nr 4-6, f.143-144.
75. **CAMAJ, Martin:** *Gjurmë të popullsisë shqiptare në provincën e Piacenzës* – Vjeti XIII, korrik- shtatuer, 1969, nr 7-9, f. 311-315.
76. **CAMAJ, Martin:** A.V. Desnickaja, “Albanskij jazyk i evo dialektov”(Gjuha shqipe dhe dialektet e saj). Botim i Akademisë së Shkencave të Bashkimit

- Sovjetik – Instituti i Gjuhësisë. Leningrad 1968). – Vjetë XIII, Korrik-Shtatuer 1069, nr.7-8-9, f.386.
77. **CAMAJ, Martin:** M.A. Gabinski, “Vozniknovenije infinitiva kak vtoricnij ballkanskij jazykovoj process. Na materiale allbanskovo jazyka. (Gjeneza e infinitivit si një proces gjuhësor ballkaniik sekondar. Mbi bazën e materialeve të gjuhës shqipe). Akademia e Shkencavet të Bashkimit Sovjetik, Leningrad, 1967). – Vjetë XIII, Korrik-Shtatuer 1969, nr.7-8-9, f. 386 -387.
78. **CAMAJ, Martin:** Kremtimet e gjashtëdhjetorit të “Diellit” në New York (Celebrazione del 60o anniversario del giornale “Diel” a New York). – Vjetë XIII, Tetuer-Dhetuer 1969, nr.10-11-12, f.404-410.
79. **CAMAJ, Martin:** Tahir Kolgjini, “Shpalime rreth Lahutës”. Istambul 1969. – Vjetë XIV, Kallënduer-Mars 1970, nr.1-2--3, f.95.
80. **CAMAJ, Martin:** *Novellistica Italo-Albanese*. Testi orali raccolti dal Prof. Luca Perrone. Firenze 1967- Vjetë XIV, prill- qershtuer, 1970, nr 4-6, f. 191-192.
81. **CAMAJ, Martin;** *Në kujtim të Peter Chiccos-it*. Vjetë XIV, korrik- shtatuer, 1970, nr 7-9, f. 232-234.
82. **CAMAJ, Martin:** Humbja e Prof. Dr. Alois Schmaus (La scomparsa del Prof. Schmaus). – Vjetë XIV, Korrik-Shtatuer 1970, nr.7-8-9, f.239-241.
83. **CAMAJ, Martin:** Sprovë për gjetjen e kriterëve në analizën e emnavet të vend-banimeve. (Saggio per la ricerca dei criteri nell’analisi dei toponimi). – Vjetë XIV, Tetuer-Dhetuer 1970, nr.10-11-12, f.351-355.
84. **CAMAJ, Martin:** *Recensione “Tregime dhe kengë popullore për Skënderbeun”, red. Qemal Haxhihasani e zihni sako, tiranë 1967, - P. Gioprgio fishta, Il Liuto delle Montagne*. Lahuta e malcisë. Fasc. I. II, Prefazione, commento, traduzione e note di Papàs Ignazio parrino, Palermo, 1968-70- Vjetë XV, kallënduer- mars, 1971, nr 1-3, f.82-89.
85. **CAMAJ, Martin:** Kuvend djalektologjik në Bressanone (14-16 shtatuer 1971),(Convegno dialectologico a Bressanone).- Vjetë XV, Korrik-Shtatuer 1971, nr.7-8-9, f.215-217.
86. **CAMAJ, Martin:** Giuseppe Ferrari, “Grammatica albanese”. Parte I. Fonetica-Morfologia. Mezzina-Molfetta, 1971. - Vjetë XV, Korrik-Shtatuer 1971, nr.7-8-9, f.255-257.
87. **CAMAJ, Martin:** Vëllim syzimesh albanologjike në nder të Atë prof. Zef Valentinit dhe prof. Ernest Koliqit. (Volume di saggi albanologici in onore di P. Valentini e Prof. Koliqi). – Vjetë XV, Tetuer-Dhetuer 1971, nr. 10-11-12, f. 329-331.
88. **CAMAJ, Martin:** Përmbajtje e Festschrift-it: (Përmbajtja e landës së vëlimit “Dissertationes albanicae” in honorem Josephi Valentini et Ernest Koliqi septua genariorum. Dr.Dr. Rudolf Trofenik – München 1971. Redaktion: Peter Bartl, Martin Camaj, Gerhard Grimm). – Vjetë XV, Tetuer-Dhetuer,1971, nr. 10-11-12, f. 347-348.
89. **CAMAJ, Martin:** *Libra të lexuem: “Meshari”i Gjon Buzukut (155)*. Botim kritik punuar nga Eqrem Çabej. Pjesa e parë – Hyrje dhe transliterim. Pjesa e dytë - Faksimile dhe transkribim fonetik. Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës.

- Instituti i Historisë e i Gjuhësisë 1968. Pagg. 299 e 404. Rilegato in lino. (Il “Messale” di Gjon Buzuku - 1555, edizione critica, a cura di Eqrem Çabej. Vol. I. – Introduzione e traslitterazione. Vol. II. – Fac-si-mile e trascrizione fonetica). – Vjetë XVI, Maj-Gusht 1972, nr.5-6-7-8, f.284-285. (Da “Südost-Forschungen”, Band XXX, pp.517-518, München 1971)(Traduzione dal tedesco in italiano a cura di Veronica Lazzarini Viti. Shënimi i redaksisë së revistës “Shëjzat”)
90. **CAMAJ, Martin:** Ernesto Koliqi, “*Saggi di letteratura albanese*”, Firenze, 197. “Studi e testi”, Volume V, pp.IV--260. – Vjetë XVII, Kallënduer-Prill 1973, nr. 1-2-3-4, f. 138-140
91. **CAMAJ, Martin:** Francesco Solano, “*Manuale di lingua albanese*”. – Elementi di morfologia e sintassi, esercizi, cenni sui dialetti. Corigliano 1972 (Adresa: “Zjarri”, S. Demetrio Corone – Cosenza). – Vjetë Kallënduer-Prill 1973. nr.1-2-3-4, f.140-141.
92. **CAMAJ, Martin:** “*Novellistica italo-albanese*”. Racconti popolari di S. Sofia D’Epiro, S. Demetrio Corone, Macchia Alb., S. Cosmo Alb., Vaccarizzo, S. Giorgio Alb. Con una introduzione di G. Gradilone, raccolta da P. Gianpietro, E. Miracco, C. Bellucci, F. Matranga. Firenze L. S. Olschki 1970, XXX, pagg. 446. – Vjetë XVII, Shtatuer-Dhetuer 1973, nr. 9-10-11-12, f. 392-393.
93. Camaj. Martin: Scompare il prof, Joseph Matl- Vdiq Prof. Dr. Joseph Matl. – Vjetë XVIII, 1974, nr 1-10, f. 89-102.
94. Camaj, Martin: Recensime”la parlata Albanese di greci in provincial di Avellino”. Firenze 1971(hans- Jürgen Sasse)
95. **CAMAJ, Martin:** Nji humbje e randë. – “Numer Perkujtumuer kushtue Prof. Ernest Koliqit. Numero Commemorativo dedicato al Prof. Ernesto Koliqi”, 1978, f. 7-9.
96. **CAMAJ, Martin:** “Cronaca dei Tocco di Cefalonia di anonimo”. Prolegomeni, testo, scritto e traduzione a cura di Giuseppe Schirò. Accademia Nazionale dei Lincei. Roma 1975. Faqe XXI + 619. (Kronika e Toko-ve të Qefalonisë anonime). – “Numër Përkujtimuer kushtue Prof. Ernest Koliqit. Numero Commemorativo dedicata al Prof. Ernesto Koliqi”, 1978, f. 365-366.
97. **CAMAJ, Martin:** Shkrimi Shëjt – Katër Ungjijt dhe Punët e Apostujvet – Përkthye shqip prej teksteve origjinale nga Msgr. Dr. Joseph J. Oroshi, Romë – New York 1978. – “Numer Perkujtumuer kushtue, Prof. Ernest Koliqit. Numero Commemorativo dedicato al Prof. Ernesto Koliqi”, 1978, f. 376 - 377.

Literatura:

- Revista “Shëjzat” (Le Pleiadi), nr. 1-18. Romë, 1957-1975.
- Revista “Shëjzat” (Le Pleiadi), numër përkujtimor, Romë.1978.
- Willy Kamsi, “Shkëndija”- 1940-1943, “Shëjzat”-1957-1978, botime Françeskane, Shkodër 2009.
- Tomor Osmani. “Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor” (Studime), 2006.

